

INTERVISTË ME SKENDER MUÇOLLIN

Prishtinë | Data: 12 tetor, 2023

Kohëzgjatja: 140 minuta

Të pranishëm:

- Skender Muçolli (i Intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Skender nëse mundeni me u prezentu, me na tregu vitin e lindjes, diçka për kujtimet e juja t'hershme të fëmijërisë?

Skender Muçolli: Unë jom Skender Muçolli, i lindur në fshatin Bajqinë, komunës të Podujevës në vitin 1949. Kom jetu në fshat në vendlindje deri në vitin 1960 pastaj jam shpërngulë në Prishtinë. E ditët e sotit jetoj në Prishtinë.

Anita Susuri: Në çfarë familje jeni rritë?

Skender Muçolli: Familja në fshat osht' marrë me puntë e bujqësisë. Gjyshi më është marrë përpos bujqësisë edhe me tregti. Më kujtohet që gjyshi ka udhëtu për tregti në Selanik, ka udhëtu në Tiranë, ka udhëtu në Stamboll, ka udhëtu në Sofje. Kjo në kohën e Perandorisë Osmane. Sot ekziston pasunia e gjyshit në fshat. Ni axhë e ka trashëgue, është me djem të vet. Ata jetojnë ende në fshat. Axhallarët tjerë në Prishtinë janë.

Anita Susuri: Për gjyshin e juj m'tregut m'u dokë interesante, a osht' marrë me tregtinë e... çka ka tregtu?

Skender Muçolli: Ka tregtu gjanat elementare për nevoja të popullatës në atë zonë. Përpos gjanave ushqimore ka ardhë në shprehje tekstili, shtofnat prej Stambollit, shtofnat prej Lindjes të Mesme. Në Selanik qashtu, në Tiranë. Domethanë këtë trekëndësh Shkupi, Tirana, Selanik, Sofja, Stambolli. Domethonë ka pasë fushë veprimtarinë e tregtisë në zonat e Perandorisë Osmane. Kuptohet këto të Jeni Pazarit ka ardh në shprehje, Novi Pazar i sotit, e kështu.

Anita Susuri: E dyqan ku ka pasë?

Skender Muçolli: Kanë pasë dyqanet në Prishtinë edhe në Podujevë edhe në fshat për në atë kohë vitet 1920-1930, '40-ta. Tani me ardhjen e socializmit në Kosovë ato veç kishin pushu, ato aktivitete. Konfiskime të ndryshme, nacionalizime të ndryshme. U duft me ju përshtatë jetës në socializmin jugosllav. Deri në kohën e pavarësisë kuptohet.

Anita Susuri: Pas luftës që thatë, pas Luftës të Dytë Botërore a ju janë konfisku dyqanet e mallrat apo...

Skender Muçolli: Jo, jo. Nuk kanë pasë ashtu me vëllim, me vëllim të madh po partnerët e babgjyshit, partnerëve të babgjyshit ju kanë konfisku. Sot osht' televizioni, ku osht' i Prishtinës, pronë e partnerëve të babgjyshit, familjes Ajvazi. Këta janë kanë ma kanë punu me shumë, kanë pasë pasuni ma të madhe. Kanë konfisku në Podujevë, kanë konfisku në Prishtinë. Kësaj familje.

Anita Susuri: Si e kujtoni ju kohë si fmi në atë vendin ku keni jetu?

Skender Muçolli: Po jeta në fshat, jeta në fshat. Shumica janë marrë ose të gjithë janë marrë me bujqësi e blegtori. Shkollën fillore, msimi, s'ka pasë diçka. Me këto lojnat, lojnat në fshat. Ritet e bujqësisë e blegtorisë. Udhëtimet deri në qytet. Qajo jetë. Me to jem marrë, me to kem jetu në qat' far' forme. Po ishim të knaqun shumë në atë kohë.

Anita Susuri: Organizimi i familjes juj si ka qenë edhe sa persona keni qenë n'familje? Vllazën? Motra?

Skender Muçolli: Po familja e gjerë, babgjyshi pesë djem tana t'gjithë shpija në veti. Kam pasë katër motra edhe tre vllazën janë konë, shtatë krejt. Plaku jonë osht' marrë me bujqësi thjeshtë. Ma vonë në Prishtinë ka punu në ndërmarrje ndërtimore dhe ndërmarrje tregtare si punëtor ndihmës kuptohet. Kem pasë edhe tokë edhe kem ende tokë në Prishtinë, trashëgim prej fshatit edhe në qytet atë tokë. Kem ba ni jetë të varfun thujse, si gjithë popullata e Kosovës, përqindja ma e madhe, fukare. Ma tepër s'di çka me thanë, diqysh i bjen... po...

Anita Susuri: E vendi ku keni jetu si ka qenë?

Skender Muçolli: Po vendi...

Anita Susuri: A ka qenë fshat i madh?

Skender Muçolli: Fshati është i madh, fshati buzë Llapit. Aty jeta osht' zhvillu. Llapi. Ujitja, prodhimet bujqësore, prodhimet blegtorale. Ni fshat i zhvillun për n'atë kohë me msus shumë, me pioner të arsimit në atë fshat për rrethin e Llapit kanë qenë kryesor, thujse kryesort. E kështu.

Anita Susuri: E shkolla a ka qenë afër?

Skender Muçolli: Shkolla po, shkolla në fshat, shkollë fillore katër klasë. Ka përfshi tri katune, katër katune gati ka përfshi, katër fshatra qat' qendër. Pastaj shkolla fillore e plotë në Podujevë. Në atë kohë s'ka pasë shkollë të mesme, flas deri vitet e '60-ta. Mas '60-tave me zhvillimin kanë ardhë në shprehje

edhe shkolla e mesme në Podujevë edhe pjesa tjetër mas '60-tave fakultetet në Prishtinë. E kështu me radhë.

Anita Susuri: N'klastë t'pestë thatë që keni udhëtu pastaj se nuk ka pasë n'fshat mo shkollë. A ka qenë vështirë?

Skender Muçolli: Po gjithë nxansat pas shkollës fillore nëpër këto qendra që i përmenda, nëpër fshatra, shkolla katër klasëshe kanë udhëtu deri në Podujevë prej tona zonave të trevës së Llapit. Pesë kilometra, dhjetë kilometra deri edhe 20 kilometra radiusi, largësisë prej qendrës së Podujevës në qendra ma të thella.

Anita Susuri: E fshati juj sa ka qenë larg?

Skender Muçolli: Pesë.

Anita Susuri: Pesë.

Skender Muçolli: Pesë. Për çdo ditë kem udhëtu në mëngjes dhe jem kthy pas dite.

Anita Susuri: A ju kujtohet qysh ka qenë atëherë sistemi arsimor? Çka keni msu n'shollë? Çfarë libra keni pasë?

Skender Muçolli: Po gjithë na duket si ajo formë ka qenë ma e mira, ma e mira. Msust ma të mirë. Ata msus shumica e tyne pastaj kanë ligjeru edhe n'fakultet. Janë... si e ki këtë Shefki Sejdiun, gjuhën frënge. Selman Bryma, fizika. Të gjithë ata kanë kalu pastaj në universitet. Na duket që ai sistem ka qenë fort i avancun. Mënyra klasike e mësimi. Kah letërsia janë dalë shumë shkrimtarë, janë dalë shumë hulumtues.

Hakif Bajrami është i asaj gjenerate, tash osht' hulumtues i historisë. Sabri Hamiti është i letërsisë. Arte ki, Kadrush Ramën e ki të arteve. Ka edhe të tjerë që s'po m'kujtohen për momentin. Ana tjetër, ana e rezistencës ndaj pushtuesve, ajo anë ka përfshi shumë, shumë militant, shumë atdhetarë. Ni Shala, n'vitin '62... Samit Kabiti, baca Adem Demaçi ma ajo veç kuptohet. Këto janë aktivitete politike para '68-tes. Mandej edhe '68-ta e ka burimin m'u nga kjo trevë. Treva e Llapit, treva e Podujevës me aktivitete e '68-tes në Prishtinës edhe me degët në Ferizaj, Gjilan.

Anita Susuri: Deshta fillimisht me ju pytë për kohën kur keni ardhë vitet e '60-ta në Prishtinë para demonstratave që janë bo '68-ten. Në '60-ten ju keni qenë në shkollë të mesme apo qysh?

Skender Muçolli: Filloren e kam tetë vjeçe e kam të mbarune në Prishtinë. Klasën e shtatë edhe të tetë ajo kohë është '62, '63 m'duket. Masnej shkollën e mesme '62-'63 dhe '63-'64 deri '67 po i bjen qashtu.

Anita Susuri: Në Prishtinë kur keni ardhë... pse keni vendosë me ardhë fillimisht në Prishtinë?

Skender Muçolli: Po si gjithkund në Kosovë jeta në fshat ka qenë ma e vështirë. Përpos bujqësisë e blegtorisë s'ka pasë ndonjë mundësi tjetër. Me këto veprimtari kanë qenë të vështira përpos ekzistencës minimale, naj mirëqenie s'ke mujt ta fitojsh. Sigurimi i socialit ka qenë... siguria, spitalet, shkolla ka ndiku ata në mënyrën shkakun e shpërnguljes. E këto elementet kryesore sikur gjithkund në Kosovë që shpërngulen në fshat - qytet, janë kanë qito shkaqet kryesore. Arsimi, punësimi edhe pjesa e shëndetësisë, spitali, kjo, raste...

Anita Susuri: Thatë që jeni vendosë dikund te tregu....

Skender Muçolli: Te Medresa e mesme ku osht' Alaudin, qaty jena vendosë në vitet e '60-ta.

Anita Susuri: Qysh ka qenë atëherë Prishtina? Lagja ku keni jetu qato vite?

Skender Muçolli: Po lagja me shpi të shpesha, me rrugicë të ngushta, elektrifikimi në qat' kohë pat' fillu, pa kanalizim, pa rrugë. Lumi i Prishtinës kalojke përmes lagjes. Do rrugica të ngushta përskej lumit ose komunikimi në disa pjesë është bo nëpër lum. Kuptohet në kohërat të vërshimeve ai komunikim ka qenë i paralizun, s'ka pasë mundësi. Vetëm kalimi tërthorë. N'atë kohë është nxirrë edhe zhavori për nevoja t'ndonji pune, ndonjë... e kështu.

Anita Susuri: E qyteti çfare ka qenë? A keni dalë?

Skender Muçolli: Qyteti n'atë kohë, n'atë kohë janë fillet e ndërtimit me banesa kolektive, fillet e ndërtimet me banesa kolektive. Pjesa e vjetër edhe sot ku ekziston tregu osht' e asaj kohe, nuk ka ndonjë transformim tjetër. Përpos ksaj pjesës tjetër e cila ka marrë hov pas viteve '70-tave në ndërtim e deri në ditë t'sotit.

Anita Susuri: Në atë kohë a keni frekuentu për shembull jetën shoqërore kështu? Me shku ndoshta në teatër apo kinematë këtu që kanë qenë?

Skender Muçolli: Po teatri e kinemaja në atë kohë osht' frekuentu në mënyrë të organizune. Nga shkolla kem shku në teatër, nga shkolla kem shku në film, nga shkolla kem shku në shëtitje, kështu ka qenë ajo. Nuk ka pasë iniciativa thjeshtë private. Po ma tepër në mënyrë të organizune, në mënyrë kolektive. Kështu rresht kem shku në teatër. Pjesë teatrale që u jepshin... ni shkollë e kish ni ditë pjesën teatrale, ni shkollë tjetër ditë.

Kështu që këto janë përcjellë, pjesa kulturore në këtë formë. Sistemi i arsimit i ka pasë ato në agjendën edhe në organizim. Pjesa sportive në klube kush ka pasë talent ka pasë mundësi. Jo naj mundësi se

ata që kanë diktuar, ata që kanë udhëhequr rendin, ata kanë pasë përparësi më tepër. Po ka pasë edhe talenta të tilla që kanë arritur edhe në fushën sportive me depërtuar qat' kohë po me një ritëm fort, fort të kadalshëm, fort, fort të cungun. S'ke pasë shanse me depërtuar, veç me kanë diçka ekstra talent edhe në sport po edhe në dije...

Anita Susuri: A ju kujtohet ndonjë rast kur keni shkuar në këto vizita?

Skender Muçolli: Po jo...

Anita Susuri: Ose çfarë shfaqje kanë qenë? Çfarë filma?

Skender Muçolli: Filmat, filmat çka kemi pa na prej filmave, çka na kujtohet, qata që janë prezentuar qata filma. S'ka pasë aty me zgjedhë, në film dhetë ditë, 15 ditë ka ardhë. Çka ka filma, Ali baba edhe 40 hajdukat, film s'po di unë çfarë filmi ka qenë në atë kohë. E mbaj mend prej shkollës fillore në Podujevë tani edhe në Prishtinë. Jo diçka me thanë interesant, diçka interesant që si fenomen filmi, diçka që prezentohet aty ngjarja, ajo kjo.

Anita Susuri: Po më interesoj se ka pasë shpesh filma me partizan që kanë qenë...

Skender Muçolli: Ajo më vonë. Pushteti aktual i ka prezentuar ata filma, s'ke pasë zgjedhje aty tash, qata.

Anita Susuri: Mirë. M'është që keni vazhduar pastaj edhe shkollën e mesme, po kur ka ndodhë që keni hyrë në këto rrjedhat politike, aktivitete?

Skender Muçolli: Po dikur vitet e shkollës të mesme, vitet '62-'63.

Anita Susuri: Cilën shkollë është që keni qenë?

Skender Muçolli: Shkollën e mesme.

Anita Susuri: N'cilën?

Skender Muçolli: Fillet e shkolles të mesme teknike. Qito vite jom ra në kontakt me njerëz, me persona si në shkollë si jashtë shkolle që janë marrë me ide atdhetare. Shkolla teknike në atë kohë ka qenë diku të gjimnazit edhe sot është ajo. Aty i keni atdhetarët kryesor të asaj qendre. Në tri degët e shkollës ndërtimi, elektroteknika edhe makineria. Nxënësat edhe profesorët e asaj shkolle do të jenë bartësit kryesor më vonë, rrjedhave të ngjarjeve të viteve '68-ta.

Sigurisht nxënësat e kësaj shkolle, shumica e tyre kanë pasë kontakte edhe personale me atdhetarët e mëparshëm të cilët janë grumbulluar rreth bac Adem Demaçit. Në si grup i ri kemi pasë ato kontakte.

Shumica prej nesh me pjesëtarët, me atdhetarët e bac Adem Demaçit. Në seksionin e maqinerisë, degën e maqinerisë kanë gravitue nxanësit Osman Dumoshi, Ilaz Pireva, Xheladin Rakalija. Kanë gravitue Hasan Abazi i Ferizajit, ka qenë nxanës Ismet Ramadani dëshmor, i pushkatun në Ferizaj. vllaznit Sulejmani e disa tjerë.

Nxansët nga treva e Gjilanit në shkollën teknike ka qenë Asllan Kastrati, Sabit Sylja nga Podujeva e të tjerë që tash momentalisht s'po më kujtohen. Këta janë bartësit kryesor. Harrova me përmend Shemsi Rudarin, Ismajl Isufin në ndërtimtari. Shemsi Hoxha, Ibrahim Gashi, [Selatin Novosellën](#). Këta shokë të Shkollës Normale të Prishtinës. Emine Rakovica e të tjerë, e të tjerë.

Këta nxanës organizun, kuptohet edhe me të tjerë demonstratat e vitit '68 pas shkollës të mesme kuptohet. '67 mbaroj gjegjësisht '68. U organizuan në Prishtinë, në Podujevë, Gjilan, Ferizaj. Ka qenë demonstratë masive në trevat e Kosovës. Harrova me përmend edhe një i ekzekutun i Shkollës së Mesme Teknike, Afrim Loxha me prejardhje nga Peja, familja Loxha. Ai ka qenë nxanës i Shkollës së Mesme Teknike në Prishtinë.

Anita Susuri: Kur osht' ekzekutu ai?

Skender Muçolli: Osht' ekzekutue në prill të vitit '99. Inxhinier i maqinerisë në termocentrale. Në Termocentrale Kosova ka qenë i punësun.

Anita Susuri: Po m'intereson si ka ndodhë për herë t'parë organizimi? Si jeni bashku? Duke bisedu apo si?

Skender Muçolli: Unë thashë edhe përpara se kontaktet n'shköllë. Po ma konkretisht prej këtij grupi u kanë thelbi i organizimit. Në familje Dumoshi, në familjen Pireva, Rekalija, Sheholli, Kastrati, Abazi edhe Ramadani në Ferizaj, Sylejmani në Ferizaj, familja Shaqiri në Gjilan, Kastrati ma vonë si në Gjilan edhe në Prishtinë. Idetë e para për ni organizim të tillë kanë lind në fshatin Bajçincë në familjen Gjata. Familja Gjata n'atë kohë ni familje ma shumë se 40 anëtarë, të ni familjes. Aty për herë të parë ideja sigurisht kanë parapri edhe simpoziumi për Skënderbeun me rastin e 500 vjetorit. Aty ka lind bërthama e parë e epokës '68.

Anita Susuri: Çka ka qenë ideja e parë domethonë? Ideali i parë që u formu?

Skender Muçolli: Ky grup i atdhetarëve të rinjë ka pasë kontakte me grupet e mëparshme, me atdhetarët e më parshëm. Ka pasë një njoftësi me grupin e Ali Aliut edhe Kadri Halimit. Ka pasë njoftësi edhe afërsi me Hyrije Hanën edhe burrin e saj, m'doket Pajazit Boletinin. Ka pasë kontakte të vazhdueshme miqësore e shoqërore me të gjithë atdhetarët e Adem Demaçit edhe me Adem Demaçin personalisht. Kështu që frymëzimet e para edhe brumosja me atdhetarizëm ka ardhë m'u nga, m'u nga këta atdhetarët që i ceka.

Sigurisht ato bisedat miqësore e shoqnore janë sistemu në diçka ma konkrete. Ato janë pikat kryesore të demonstratave të vitit '68. Ato veç kanë hi në kritere politike me primesa edhe luftarake. Çështja e vetëvendosjes, çështja e kolonializmit, tani pasojnë të drejtat si çdo popull në botë për vetëvendosje edhe për liri. Me këto pika osht' formue ky aktivitet i viteve të '68-ta. Faktikisht, këto pika ishin ato kryesoret. Këto pika ishin platformë, ni program politik, me anë të pankartave.

Demonstratat e '68-tes ishin forma, ni prej formave ma të theksune, formave legale të asaj kohe. Se s'mund të thom ilegale se ilegale diçka e msheft. Kështu që gjithmonë i ka parapri çashtjes së atdhetarizmit legaliteti, transparenca publike. Jo naj transparencë ilegale e cila s'osht' transparencë ajo, nuk shihet po veprohet ilegalisht. Grupi jonë ose epoka e '68-tes, këta atdhetar e kanë preferu ma tepër legalitetin edhe nuk janë frikësu edhe prej pasojave. Kështu që pasojat i kanë përcjellë '68-ten po, po edhe mas '68-tes, '74-ten me gjykime drastike deri në 15 vjet, 14 vjet. Prej pesë vjete në 14.

Anita Susuri: A ju kujtohet për shembull për këto pankarta të organizimit, kur me dalë, n'sa ora me dalë? Qysh e keni bo këta?

Skender Muçolli: Po sigurisht, sigurisht organizimi konkret i kanë parapri mbledhjet konkrete me agjenda konkrete për çdo mbledhje edhe formave definitive e organizimit. Ke mbajtë disa mbledhje nëpër shpija. Te shpija e Osman Dumoshit, shpija e Selatin Novosellës, e Pirevëve, Rakalijs në Podujevë. Aty osht' bo ky programi politik me anë të pankartave. Ato janë shkru n'formë të pankartës me numër të caktun ma t'theksunet kanë qenë, "Duam vetëvendosje", "Poshtë politika kolonialiste e Kosovës", "Duam bashkimin e viseve të banuara me Kosovën".

Anita Susuri: Me shqiptarë.

Skender Muçolli: Kuptohet, të gjitha ato viset nën Jugosllavi që kanë qenë. Ato kanë përfshi Preshevën, Bujanocin, Medvegjën. Ato kanë përfshi Ulqinin, Plavën e Gucin. Ka përfshi pjesë... po tash muj me thanë Shkupin. Ta merr menja se '68-ta reflektohet edhe në Shkup. Në Shkup protestë kanë pasë nja ni muj ditë përmas grupa e Agim Xhaferit, Arbër Xhaferit. Këta atdhetar kanë qenë të frymëzun prej Gegës, s'po më kujtohet emri, veç pseudonimi i Gegës. Ai ka qenë në rangun e atdhetarit Adem Demaçit për pjesën e Maqedonisë sotshme, Tetovë e Shkup e Gostivar e Kërçovë, Dibër e Strugë.

Kjo pjesa e Ulqinit në grupin tonë është reprezentu prej Zaim Kurtit. Ai si nshanës edhe shkollën e mesme teknike në Prishtinë, harrova përpara me përmend. Aty edhe profesor Sadri Fetiu ka dhanë kontribut shumë të madh. Sa i përket programit me pankarta, përpos vetëvendosjes, "Poshtë politika kolonialiste", kanë qenë edhe pankartat, "Duam drejtat tona", "Askush t'mos luan me fatin tonë"... edhe tjerat s'po më kujtohen kështu potencialisht, ndoshta ndërkohë më bjen në mend diçka e ndërlidhem në bisedë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Zotëri Skender, dashta edhe me ju pytë për ditën që ka ndodhë protesta, çka kujtoni krejt prej fillimit deri në mbarim?

Skender Muçolli: Në atë ditë sipas detyrave që kishim marrë na si anëtarë të ekipit që organizoj '68-ten, unë personalisht kam qenë i angazhuar rreth pankartave me i përgatitë, me i shkru edhe me i formësu së bashku me Ilaz Pirevën dhe Selantin Novosellën. Të cilat pankarta në momentin e caktun, kohën e caktune, vendin e caktun s'bashku na tre vet i kem përcjellë me ni qerre kuajsh. Para qerres printe Selatini, Selatin Novosella. Mas qerrës e përcillshim unë edhe Ilaz Pireva. M'u kujtohet marshuta e cila ishte e caktune paraprakisht. Për shkaqe sigurie e ndrojt udhëtimin...

Anita Susuri: Kahjen, po.

Skender Muçolli: Kahjen edhe drejtimin. Pse mendonin që n'qoftëse bijnë n'dorë pankartat ose qerrja me pankarta ajo u prishte, u cunjojke, s'kishe çka prezenton në demonstratë. Në mungesë të pankartave ajo do t'ishte e thatë. Kështu që patëm sukses në këtë ndrrim të marshutës, të kahjes e drejtimit. Në momentin e caktun arritëm n'cak edhe i shpërndam të gjitha aty mrena pesë minutave, as pesë minuta s'ka ba. Janë shkepë krejt qerrja si ish. Kuptohet ni qerre me kual. Tri metra me ni metër e gjysë. Sa ka pasë pankarta? Nja 100 copa. Ma tepër numri s'po më kujtohet. Të gjitha janë marrë edhe kanë fillu.

Kem pasë edhe flamuj kombëtar edhe flamujt me shtiza edhe ka fillu. Prej qendrës të Fakultetit Filozofik, prej oborrit ku osht' sot Biblioteka Kombëtare para Radio Prishtinës kuptohet ai oborri që është, sheshi. Bash ku osht' sot biblioteka prej atyhit ka fillu e jena dalë n'rrugë kryesore. Në të djathtë edhe kem marshu drejt qendrës. Kuptohet qendra e asaj kohe ku osht' sot përmendorja e Zahir Pajazitit, ku osht' përmendorja e Skënderbeut, teatri. Aty ka qenë Prishtinë. Marshuta osht' udhëheqë prej anëtarëve tonë të cilëve ju ka bashkangjitur turma e studentave, turma e popullatës. Me mijëra vet deri në orët e vona të asaj dites.

Anita Susuri: A ju kujtohet kur ka fillu policia me ardhë?

Skender Muçolli: Policia qysh në start ka reagu policia. Me të dalë transparente pankartave, flamujve në rrugë kryesore, aty rezistenca e parë prej policisë, ku kishte edhe shprazje armësh. Po kuptohet, shprazje e armësh në qiell ma tepër për me alarmu pjesën tjetër të policisë që ka t'shtine me armë ose m'i frikësu. Po turma ka vazhdu tutje. Ora ka qenë e fillimit, ora katër, pesë minuta para katërve. Aty për ni orë, nëntori muzgu. Veç kryesorja defilimi ka qenë deri në qendër të qytetit për dritë, ma vonë tani terri e mbuloj atë pjesë. Policia ka vepru ma shumë me shpërndarjen po s'ka arritë m'i shpërnda deri orët e vona. Domethonë aktiviteti osht' plotësu edhe kry plotësisht ashtu si e kem mendu. Deri në orët e vona të mëngjesit.

Anita Susuri: A ka pasë dhunë prej policisë?

Skender Muçolli: Dhuna, thashë, u përshpejtu dhuna. Me ramjen e muzgut ka pasë edhe shtimje të armëve, ka pasë plagesa me armë, ka pasë vdekje. Vdes nga pasojat e armës nxanësi im, Murat Mehmeti, dëshmor i asaj kohe. Plagosur edhe shumë të tjerë, afër 30 vetë të plagosur në forma armësh, në forma të ndryshme. Aktiviteti ose protesta e kësaj forme demonstrimi i kësaj forme të njejtën kohë bohet Besian që udhëheqet prej Xheladin Rakaliut, Akif Shehollit, Sabit Sylës, Ahmet Abdullahut e të tjerëve. Në Ferizaj demonstratat udhëheqen prej Ismet Ramadanit, Hasan Abazit, prej vllaznive Sylejmani. Në Gjilan prej Asllan Kastratit, Irfan Shaqirit, Rexhep Malës si nxanës i... për të njejtën kohë.

Anita Susuri: Kur keni planifiku m'i organizu këto, a, çka keni mendu që keni me arritë? A keni mendu fillimisht që ka me pasë sukses?

Skender Muçolli: Po sigurisht. Thelbi i kësaj osht' kundërshtia me ose ndaj pushtuesit që e konsideronim në atë kohë Jugosllavinë. Ni formë kundërshtuese, ni artikullim që Kosova, ose shqiptartë e Kosovës mendojnë edhe s'pajtojnë me regjimin, me pushtimin e Kosovës. Sigurisht ky pushtim osht' pushtimi i mram se ka pasë edhe pushtime tjera. Pushtimi i Kosovës në vitin 1912 nga Serbia, nën mbretëri. Tani masanej socializmi pas Luftës së Dytë Botërore. E kështu, në këtë formë diçka.

Anita Susuri: Në këtë kohë domethonë '68-ten ka pasë edhe burgosje edhe ju thatë që edhe ju jeni burgosë në '68-ten.

Skender Muçolli: Po.

Anita Susuri: Si ka ndodhë kjo? Ku keni qenë?

Skender Muçolli: Unë thashë, kjo forma e organizimit ka qenë formë legale dhe forma e veprimtarisë jo ilegale 100 për qind, jo legale qind për qind, gjysë ilegale ma shumë legale kuptohet. Kjo krejt për shkak të artikullimit të kërkesave të bohen këto jo të mshefta po le te dinë krejt bota që ekziston ni popullatë e cila kërkon forma të pavarësisë. Kuptohet regjimi i ka përcjellë ngjarjet, burgosje paraprake s'ka pasë për me pengu. Ndoshta ka pasë hetime po ato s'kanë pasë pasoja për me pengue ni ngjarje të tillë.

Pas demonstratave kanë fillu burgosjet. Janë identifikuar personat edhe burgosen me burg të randë në Prishtinë, tre vet në Podujevë, tre vet në Gjilan, katër vet në Ferizaj. Prej ni vjeti deri pesë vjet burg të randë. Burgjet janë majtë ma vonë nëpër krejt pjesët e Jugosllavisë jo në Kosovë. Në Nish, në

Mitrovicë të Sremit, Pozharevc, Idrizov në Maqedoni, Goli Otok, Lepoglava, Gradishk të Kroacisë, Foca Sarajevë. Këto janë konë të shkepun.

Unë me ni grup të shokëve kem majt në Nish burgun. Burgu i Nishit është një qendër mjaft e madhe, diku në hymje të Nishit ekziston. Të tjetër i kanë majtë nëpër kto që e ceka, nëpër krejt Jugosllavinë. Edhe në Goli Otok ni grup i Podujevës në Goli Otok ka majtë. Ashtu jem kanë të shkepun nëpër krejt, këto masat pushtuese që i ka pa marrë n'atë kohë.

Anita Susuri: E juve kur ju kanë nxon a ka qenë gjatë demonstratave apo pastaj?

Skender Muçolli: Jo, unë kom qenë i plagosun me armë zjarri edhe ashtu të plagosun m'ka dërgu dikush në spital.

Anita Susuri: Ku jeni vra? Ku jeni plagos?

Skender Muçolli: Dikund te sheshi i sotshëm Zahir Pajaziti, n'qat pjesë, në krahorr. Ashtu t'plagun m'kanë çu n'spital. Jam shtri n'spital aty. T'nesrit në mënyrë direkte pa hetues, pa hetues, ka ardhë gjykatësi hetues edhe m'ka komunikuar që, "Ti je i arrestun". Pa më marrë n'pytje, pa më marrë kurgjo. I shtrim në spital. Aty ma kanë pru rojen polic edhe ai m'ka ru krejt kohën sa kam qenë n'spital. N'spital kam qenë nja, n'spital të Prishtinës diku afër tri javë dite. Nuk jom bo operacion, s'kanë mujtë me nxjerrë në atë far' kuptimin qashtu, konstatim i mjekve. Masnej drejt në burg më kanë çu. Se ke forma e arrestimit prej spitalit... në spital i arrestun kur u lirova prej spitalit më kanë çu te gjykatësi hetues, gjykatësi hetues ka marrë masën e burgosjes. Kuptohet, në atë far' formën klasike me burg...

Anita Susuri: Prej spitalit në Nish ju kanë dërgu a?

Skender Muçolli: Jo në Prishtinë. Për Prishtinë është fjala se Nishi osht' mas gjykimit. Kur ka marrë gjykim formën e preme na kanë transferue ni ditë. Më kujtohet mas nja katër mujve a sa na kanë çu në Burg të Nishit së bashku me Afrim Loxhën. Lidhun bashkë në tren, me përcjellje të policisë edhe...

Anita Susuri: Me tren.

Skender Muçolli: Me tren, s'ka pasë rrugë atëherë. E mbaj mend trenin, trenin e mëngjesit para sabahit, para orës pesë ka mrrë në Nish. Drita atëherë ka qenë dikun qershori, më kujtohet qershori. Qershori edhe prej atyhit drejt në burg. Në burg dihet.

Anita Susuri: E këtu në Prishtinë hetimet sa kanë zgjatë?

Skender Muçolli: Po hetimet kanë zgjatë në Prishtinë deri në gjyq, deri në gjykim. Prej nëntorit, faktikisht dhjetorit-nëntorit deri në prill. Deri në prill të vitit pasues, vitit '69 po i bjen.

Anita Susuri: Zoti Skender, thatë që prej spitalit ju dërgun meniherë në Burgun Hetues të Prishtinës. Qysh ka qenë fillimisht kjo arritja juje në atë burg? A ka pasë intervistë informative? A ka pasë dhunë? Qysh ka qenë?

Skender Muçolli: Me të ardhun në burg nga spitali ka fillu paralelisht procedura hetimore nga ana e sigurimit shtetnor të asaj kohe dhe paralelisht pjesa hetimore e gjyqësisë. Pjesa e sigurimit shtetnor u zhvillu prej personave të caktun të sigurimit shtetnor. Unë e kom pasë në hetues, në msus, ish msus nga Peja me emrin Hajri Gjoda. Koicidencë ai kishte qenë msus në filllore të Afrim Loxhës në Pejë. Afrim Loxha tash ishte në proces të hetimeve. Ai, atij ju kishin caktu për me përpunë landën e hetuesisë ndaj meje edhe Afrim Loxhës. Ai ishte msus.

Ni prej pyetjeve, prej insistimeve kryesore nga ish msusi ishte ajo që përgjigjen atij ish msusi ia jepshim, ose ka dhanë i ndjeri Afrim Loxha, duke deklaruar që këto mësimet të organizimit të viteve '68 i kem marrë prej msusave. Ajo i binte që ai msusi, domethonë, frymëzimet e para për atdhetarizëm i kem marrë prej msusave. Ai ish msusi, me kuptu. Për koicidencë disa herë ka asistuar edhe në hetues të cilin familja në fshat e jona e ka njoftë. Atë hetues edhe unë e kisha msus të gjuhës shqipe. Kështu që përgjigjet gjithmonë kanë shku në atë drejtim që na s'kem marrë prej tjetër kujt po prej msusave e msusave si ti që ke qenë msus, e si ti aty.

Krejt kjo me qëllim të amortizimit ndaj dhunës eventuale. Kështu që përpos dhunës, kuptohet, psiqike vetvetiu që je i arrestun, vetvetiu që po merresh në pyetje nga siguri shtetnor, nga policia. Ajo vetvetiu osht' dhunë psiqike. Dhuna fizike kuptohet pse po përballesh me kushte të burgut. Aty jeta në burg osht' e randë. Ajo mund të quhet diçka. Kurse ndonjë dhunë klasike nuk ka pasë. Mu s'më kujtohet që ka pasë. Ndoshta shoktë tjerë e te dikush ka theksu ndonjë dhunë e diçka ma specifike. Unë për veti, qito ka kalu ajo koha e hetimeve.

Anita Susuri: Gjatë kohës së hetimeve, dashta me ju pyetë, a keni pasë kontakt me familjen? A ju ka leju vizita?

Skender Muçolli: M'doket, m'doket, m'doket, m'doket jo nja në muje ditë a ma tepër sa më kujtohet. Mas në muje kanë marrë leje prej gjykatësit hetues. Gjykatësi hetues paralelisht i ka bo hetimet e veta. Paralelisht me hetimet e sigurimit shtetnor. Në Riza Fazliu në atë kohë ai person nuk ka insistu diçka për të rëndue, nuk ka insistu ai person. Ai ma vonë ka qenë edhe kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës. Po ka qenë edhe në aktivitete sportive kryetar i Klubit të Boksit, "Prishtina", në atë kohë. Çka e ka dallu këtë person prej gjykatësit kryesor që na i ka shpallë aktgjykimin e na ka dënu me burg, Nazmi Junikut.

Nazmi Juniku u konë ma i rreptë, ma i ashpër edhe ai ka marrë pjesë ndonjëherë gjatë hetimeve të gjykatësit hetues. Çka ka qenë normale kryetari i grupit gjyqës të ardhshëm me marrë pjesë në

hetime. Po atij i shkon landa edhe ai vendos sipas mendjes t'tina. Aty e kem pa dallimin e këtij Riza Fazliut si gjykatës hetues prej Nazmi Junikut. Shumë ma pozitiv. Masanej nuk e di çka ka përfundu, aktivitetet e tina. Sistemi i autonomisë të Kosovës si ka funksionu, dihet ajo. Ndoshta dikush i hulumton këto pak ma detalisht. Aktivitetet e tyne, kontributet si të kqija si të mira të ktyne personave.

Anita Susuri: Nëse mundeni pak me na përshkru, Burgu i Prishtinës për shembull, qelitë çfare kanë qenë? Kushtet? Ushqimi?

Skender Muçolli: Po çdo dy javë na kanë sjellë paketa nga shpija. Ushqimi në atë kohë osht' bo në mënyrë primitive, osht' sjellë me kazan. Do pjata i kem pasë. Ato dilshim te dera vijke te dera e dhomës dy veta e majshin kazanin edhe ashtu ta qitke. Në dhomë ishim katër vet. Dy herë në ditë dilshim për nevoja personale. Në mëngjes edhe në mramje. Dhoma ka qenë e vogël, katër kreveta. Dhomë dy e gjysë me thanë me tri. Ujë s'ka pasë, kurgjo s'ka pasë.

Për nevoja personale ke mujtë m'u drejtu në derë. Gardiani në qoftëse ta ka aprovu ta ka miratu kërkesën në qoftëse jo... gjysmë ore ka pasë shëtitje, përjashtë në oborr të burgut, oborri i vogël. Ashtu me rend tana dhomat. Çdo dhomë e ka pasë të vetën. Në dy pjesë ka qenë ajo shëtitja. Dy pjesë të oborrit. Ni dhomë n'atë pjesën, ni dhomë tjetër. Qashtu ka gjysë ka gjysë deri në mramje sa dhoma kanë qenë aty.

Ni formë eliptike, rrethore e dhomave të burgut. Koridori në rreth dhomat mrena. S'ke mujtë kurrë me pasë orientimin as kah është lindja as kah është perëndimi. Gjithmonë në rreth je sillë e rrethi ta ka hupë koncentrimin që s'ke ditë ku po gjindesh. Aty u duft shumë kohë m'i mësu, me mësu cila pikë me cilën pikë. Se ka pasë të burgosur kah katër pesë vjet a e ka ditë dera kur u çelë e cilës pjesë osht', me anë të zanit, me anë të krismes. Aty shumë vështirë ish për ni kohë të shkurt për ni muj, dy muj, tre muj... aty kishin nejt me vite s'ke mujtë. Ni lloj dhune i dhunës psiqike kur je mrena.

Anita Susuri: Kur keni dalë në gjykim a keni qenë grup i madh?

Skender Muçolli: Grupa sa kem qenë të akuzun, grupa e Prishtinës e ka majt gjykimin veç. Grupa e Gjilanit e ka majt veç, Ferizajit veç edhe Podujevës veç. Sigurisht gjykimet kur janë bo, janë bo me koordinim të qendrës të Prishtinës. Prishtina, Gjykata e Prishtinës merr vendim na dënon prej tri vjetve deri në pesë vjet. Sipas kualifikimit që ia ka marrë menja gjykatësit, ky qikaq, ky qikaq, tri, pesë.

Anena dikund ni vjet, ni vjet e gjysë Ferizaji, Podujeva e Gjilani i ka dënu. Domethonë nër' ka ardhë. Tetova ka pasë gjykim në veti në Maqedoni. Tjetër, tjera pjesë nëpër Kosovë ka pasë Prizreni do për kundërvajtje ni muj, Peja diçka ni muj edhe aty. Janë do bo demonstrata të nxansave, po jo të organizun nga qendra e Prishtinës. Po qendra e Prishtinës i ka pasë qito pika Ferizaj, Gjilan, Podujevë.

Anita Susuri: Juve ju dënojnë me tri a katër?

Skender Muçolli: Tri vjet, po.

Anita Susuri: Edhe në Nish thatë që ju kanë dërgu.

Skender Muçolli: Në Nish po. Në Nish e kom kalu atë pjesë të dënimit. Masnena jena liru edhe...

Anita Susuri: E në Nish qysh ka qenë?

Skender Muçolli: Në Nish, në Nish osht' ni qendër e burgut qendër n'atë kohë ndërtesa ishte e kohës të Austro-Hungarisë. Ai projekt, ajo ndërtesë e dedikune për burg. Unë sa kom njohuri e austro-hungarisë, mos të thom edhe e kohnave, kohës të osmanishtes, kohës të Perandorisë Osmane. S'mendoj ashtu, mendoj të Austro-Hungarisë. Me stil të projektimit, me koridore të gjata, kah dy dhoma të mëdha, kah 70-80 vet. Koridor djathtas, shmajtas edhe koridor të tërthorë. Kështu {shpjegon me duar horizontalisht dhe drejt} domethonë ni T.

Anita Susuri: Si plus?

Skender Muçolli: T germa. Prej s'naltit T. Dy dhoma knej, dy dhoma knej {majtas dhe djathtas} edhe dy dhoma anej {drejt}. Kati i dytë. Dy katëshe më doket ose tri katëshe, s'më kujtohet. Me pasë ni fotografi e di meniherë dy a tri. Kah 70-80 vet sipas moshës që e kanë pasë. Aty më kujtohet ata që ishin nër' 22 vjet, 18-22 qanena {majtas}. Që ishin tjetër kund. Të burgosurit ordiner, vrasje, vjedhje, plagesa, mashtrime nëpër dhoma kuptohet... aty kanë qenë të dënun njerëzit edhe për aktivitete politike. Ka pasë prej shqiptarëve me kah 17-18 vjet. 20 vjet dënimi ma i madh ka qenë.

Anita Susuri: A ju kujtohet që ka qenë dikush në kohë qatyne ngjarjeve?

Skender Muçolli: Po, po, po.

Anita Susuri: Kush ka qenë?

Skender Muçolli: Kanë qenë në atë kohë ni Lushtak i Drenicës nëse më kujtohet. Ai prej epokës të aktiviteteve të Shaban Polluzhës, atdhetarit e luftëtarit të Drenicës. Dikush prej tyne në Drenicë. Do aktivitete të reformave të organizimit ballistëve¹, ni baba Ukë kah Banja e Pejës dikund, më kujtohet ai baba Ukë.

¹ Balli Kombëtar (Balli Kombëtar) ishte një organizatë nacionaliste shqiptare, antikomuniste e krijuar në nëntor 1942, një kryengritje që luftoi kundër Gjermanisë naziste dhe partizanëve jugosllavë. Ithtarët e Ballit Kombëtar kanë qenë ballistët.

Më kujtohet ni plak asht e lëkurë e majke burgun për 17 vjet, atë kohë rekordesh 17 vjet *yhyy* {onomotope}, 15 a 17. Ni Hetem Loxha i thojshin, me emër të katunit. Ai u konë fort gojëomel, fort i avyt [afreshëm]. Ai u konë 20 vjeçar unë i kom pasë 19 vjet. Ai e majke burgun 17 vjet. Kupton diferenca. E kom taku edhe mas burgut atë Hetemin, plakun.

Anita Susuri: A osht' gjallë?

Skender Muçolli: Jo, s'osht' gjallë. Hetem Ademaj. Qajo kategoria e atyne të burgosurve me thanë për çashtje të atdhetarizmit ni formë.

Anita Susuri: Qysh ju ka kalu koha në burg për shembull?

Skender Muçolli: Në burg tashi, organizimi i tij ishte asisoji. Aty ishte fabrika, fabrika e mobileve të drunit, aty ishte shkritoja e hekurit dhe produkteve të hekurit. Aty ishte fabrika për përpunimin e bojlerëve Deligrad. Të gjithë burgosurit kanë qenë të detyrun me punue. U ndrru ose në shkritoje ose në pjesët e bojlerëve. Ashtu jeta shkon aty. Dikush ka punu enë për kuzhina, dikush ka punu në lamjen e teshave, dikush ka punu në spital. Sipas kualifikimeve që ka pasë.

Në qoftëse ka qenë teknik ose student i mjekësisë ka mujt të shkoj aty. Ni i Prishtinës ka qenë, Ismet Berisha, për vepra tjera, ka pasë dalë në burg si i ri. Ai punojke teknik medicinal edhe na nimojke gjithë me barna. Aty ka pasë pushim mjekësor mos me shku në punë. Në mëngjes herët nëpër terr në vendin e punës. Qaty, qasi kushte çfare ke pasë. Bukën me veti. U kthejshe mas dite, ni shëtitje e bojshe. Ni herë në mujt ke pasë vizita.

Anita Susuri: A ka qenë vështirë për familjen me ardhë deri atje?

Skender Muçolli: Kuptohet me tren, me kerre kanë fillu në atë kohë '68-ten kush i ka pru dikush të familjes. Veç ma tepër me tren. Kom pasë plakun gjallë në atë kohë, plaku m'ka vizitu.

Anita Susuri: E n'atë kohë a keni qenë i fejun ose i martun?

Skender Muçolli: Jo, jo s'kom qenë atëherë. Edhe kështu kaloj ajo kohë.

Pjesa e Tretë

Skender Muçolli: N'dalje n'burg na pritën, na pritën shoktë që ishin dalë përpara prej burgut. Kuptohet dikush familja e Bedri Novosellës ka qenë aty, Irfan Shaqiri mas burgut, axha i Ilaz Pirevës, vllaznit edhe akrabaja [kushërinjtë] e Afrim Loxhës, do kusheri t'mi, të familjes teme. Pra, nuk dolëm për ni ditë te tanë të gjithë po për ni ditë jom shku në burg me Afrim Loxhën për ni ditë jena dalë. Ato

që e ceka ma përpara që '99-ten e pushkatojnë te posta e re aty, përskej ndërtesave. Ka edhe ni përmendore e ka aty...

Anita Susuri: Si pllakë?

Skender Muçolli: Vlen me intervistë edhe dikond të tyne po nuk kanë se tre vllazën ju ka vra, ni vlla e ka në Londër Afrimi. Agronin e ka, osht' aktiv kështu për çashtje të atdhetarizmit. Mandej edhe ni vëlla, Akilin e ka në Londër, ni motër e ka në Amerikë. Është e martune për Halil Qosjen, vëllaun e Rexhep Qosjes. Motra e Afrimit... po këtu e ka shoqen Afrimi me do, çiken e ka të martune për këtë opinionistin e televizioneve, qysh e pat' emrin, Gorani, djali i Hajrullah Goranit, ai me flokë të bardha. Shoqen e ka mjeke, pediatre. Munësh edhe ata me dhanë naj sen diçka për burrin që ju ka ekzekutu faktikisht edhe ka marrë pjesë n'qisi sene, a dinë.

Anita Susuri: Para se, po mendoj, kur jeni dalë prej burgut e keni vazhdu punën apo aktivitetin?

Skender Muçolli: Jo kom vazhdu studimet i kom vazhdue. Fatmirësisht në inxhinieri nuk ka pasë kështu që me na njëkë sikur fakultetet tjera. Në ekonomi patën marrë qëndrim mos me i pranë në fakultet, me i përjashtu për ni kohë të caktune po të pacaktune. Në inxhinieri dekani, ai personeli mësimor, ka qenë kështu pro, ajo pjesa pro demonstratave.

Profesorët Esheref Ademaj, profesor Fetah Jahxhiu, profesor Muhaxheri, profesor Zeqir Rugova. Ai ka qenë i Plavës dhe Gucisë i Hakajve të Martinajve të Gucisë. Na vazhdum. Unë vazhdova tani marova fakultetin aty masnej kam hy në punë në teknikën e ndërtimit të rrugëve. Kom maru deri në penzion, eksperiencën vetëm në rrugë edhe në ura edhe në objekte të rrugëve.

Anita Susuri: Deri në cilin vit? Kur keni dalë në penzion?

Skender Muçolli: Në 2014-ten.

Anita Susuri: Po du me folë pak për vitet e '70-ta, '71-ten keni dalë prej burgut, thatë, keni vazhdu fakultetin po edhe vitet e '70-ta nifar forme kanë pasë, ka qenë ni kohë pak ma e mirë me thanë për Kosovën. Është hapë universiteti këtu, po mendoj, ka qenë ni lloj rezultati ndoshta i demonstratave, nuk p'e di, apo thjeshtë qashtu ka qenë politika. Po qysh ka qenë për juve kjo periudhë?

Skender Muçolli: Sigurisht efektet e demonstratave të viteve '68 reflektohen edhe në vitet e pastajme. Bahen disa lëvizje, liberalizohen disa çashtje, fillon bashkëpunimi, hapja e universitetit që e kishim në pankarta, "Duam universitet", s'e përmenda në fillim. U vrejt ni lëvizje, ni formë pozitive diçka prej asaj çka kishim kërku na në formën legale me demonstrata. Pushteti i atëhershëm sigurisht ata që kishin mundësi të vepronin për çashtje të Kosovës, ata e kanë dhanë ni kontribut nëpër pjesët e pushtetit. Nuk mund të themi që kanë qenë kundër, të egër në të gjitha format.

Pjesa tjetër e pushtetit zyrtar veprohej kundër atdhetarëve të cilët ishin në regjistrin e sigurimit shtetnor të pushtetit të atëhershëm. Kështu që pjesa e atdhetarëve të viteve '68 edhe para '68-tes ndiqej vazhdimisht, malltretohej vazhdimisht në forma të ndryshme. Si në punësim, si në biseda informative. Bile ajo arrin vitin '74 edhe me arrestime masive të grupit '68, ni pjesë e madhe e grupit '68 edhe ni pjesë e grupit të '64-tes, në krye me atdhetarin Adem Demaçi.

Bahen hetime, organizohen gjykime, organizohen procese edhe në ato procese atdhetarët marrin dënime deri në 15 vjet burg të randë. Baca Adem Demaçi 15, Skender Kastrati 14, Osman Dumoshi, Selatin Novosella, Irfan Shaqiri, Ilaz Pireva, Njazi Korqa, Rexhep Mala, Isë Kastrati e tjerë e tjerë. Nja 19 vetë. Procesi i njohur i cili në atë kohë osht' konsideru si proces plotësues i procesit të viteve '68-ta. Kinse '68-ta proceset e gjykatave nuk i dhanë dënimet e meritune kështu që '75-ta e plotëson ata çka s'e bon '68-ta.

Sigurisht me ni formë ma të zgjerune, ma të plotësune edhe me persona që s'kanë qenë pjesëmarrës direkt të viteve '68-ta. Duke dënue Adem Demaçin me ni maksimum në atë kohë e të tjerët duke ju dhanë minimum pesë vjet. Kështu që ajo kohë osht' përcjellë me represale, me dhunë e cila ka vazhdu edhe në vitet e pastajme. Mas '75-tes shpërthimet e demonstratave '81 e të vazhdune deri në vitet e '90-ta. Deri te organizimi ushtarak i atdhetarëve.

Anita Susuri: E për vitin '81 demonstratat që ka qenë, a jeni mundu me u përfshi, po mendoj ajo ka qenë ma e msheft, po në çfarë forme e keni përjetu ju këto?

Skender Muçolli: Po kuptohet prej grupit '68 ka pasë aktivitete indirekte në ndikim direkt dhe indirekt në zhvillimet e demonstratave të '81-tes. Grupet ose individët vazhdojnë me aktivitete '78-ten, '79-ten. Atdhetarët si [Sabri Novosella](#) e Jusuf Gërvalla ata përsekutohen e njecken vazhdimisht. Kështu që detyrohen me u shpërngul njëri në Turqi tjetri në Gjermani. Jusuf Gërvalla me shkrimet në "Zërin e Kosovës" edhe me aktivitete e grupe të formave në Gjermani osht' kontribut i asaj epoke për çka edhe likfidohet në '81-ten.

Sabri Novosella e ndrron vendbanimin prej Turqije në Suedi, prej Suedisë në Kanadë. Ka lëvizë, ka lëvizë s'ka qëndru ni vend. Pjesëtar i asaj grupe [Metush Krasniqi](#) ose me thanë strumbullari i këtij grupi ai vazhdimisht ka qenë në kontakt me studenta. Sigurisht ka dhanë instruksione, udhëzime. Po barrën kryesore studentat e Universitetit të Prishtinës. Bajram Kosumi, Ali Lajçi, Gani Koci, mos t'i përmendi se i njoh edhe ata personalisht shumë.

Anita Susuri: Mehmet Hajrizi.

Skender Muçolli: Mehmet Hajrizi.

Anita Susuri: E a e keni ditë ju në atë kohë që ekzistojnë këto grupet ilegale ose kto trakte që kanë shpërnda?

Skender Muçolli: Kqyre ajo osht' zhvillim, osht' zhvillim ni procedurë, ni proces i cili deri në '81-ten kem pasë mundësi m'i njoftë personalisht atdhetarët. Të gjithë që i përmenda, Jusuf Gërvallën, Metush Krasniqin. '81-ten u bon shumë. Domethonë u prodhu atdhetarizmi qaq shumë që ka qenë e pamundur m'i njoftë krejt. Ma vonë e kom njoftë Bajram Kosumin, e kom njoftë Mehmet Hajrizin, [Hidajet Hysenin](#).

Anita Susuri: A po ju kujtohet...

Skender Muçolli: Ali Lajçin e tjerë.

Anita Susuri: Me 11 mars ka ndodhë për herë t'parë domethonë që ka ndodhë në '81-ten po pastaj me 1 edhe me 2 prill ka qenë ma e fuqishme...

Skender Muçolli: Tash po të tregoj kështu, atmosfera, atmosferën e demonstratave 11 prillit, 11 prilli, jo 11 marsi se gabova.

Anita Susuri: 11 mars, po.

Skender Muçolli: 11 mars osht' faktikisht ajo periudha e kalimit prej dimrit në pranverë e në verë faktikisht. Ni mars me diell. Vetvetiu ajo atmosferë e demonstratave na i përkujtojnë demonstratën e '68-ten, vetëvetiu aktiviteti. Ishte ni knaqësi asisoji. E dishim që procesi po shkon pozitivisht. Rezistenca po shkon me të vërtetë, po ecë përpara. Të gjitha ato protestat ma vonë janë përkujtu ose përndje kësi soji. Dua të thom mendum që po vjen ni kohë, ni epokë e vazhdueshme në rezistencën ndaj, që e konsideruam ne pushtues. Se edhe autonominë e Kosovës e kem konsideru pushtues.

Bile epoka e '68-tes kurrfar forme nuk ka pranë përpos asaj që në programin e vet viteve '64-ta e ka pasë Adem Demaçi. Gjithmonë është mendu bashkimi qysh e ka shpreh ai me nanën Shqipni. E ka atë thanjen e vet, tjera forma nuk ka dhanë tjera forma. Megjithëse ma vonë jo republika, ja asi, na, grupa jonë nuk ka marrë pjesë në ato forma me u reformu. Nashta kem qenë pak ma konservator n'atë far' kuptimin po e kem rujtë atë formën e asaj kohe. Megjithëse evoluimi edhe zhvillimet e ma tutjeshme kanë ardhë deri ku jem sot.

Anita Susuri: E qato ditë keni qenë në punë apo si e keni kuptu...

Skender Muçolli: Po, po në punë.

Anita Susuri: A ju keni bashkangjitur ma vonë demonstratave?

Skender Muçolli: Po, po si pjesëtar, sikur çdo tjetër pjesëmarrës në organizime. Punëtorët e “Ramiz Sadikut” kanë qenë aty, punëtorët e ndërmarrjes PUT që ishim atëherë ose ndërmarrjeve tjera kuptohet ajo masivisht. Studentat, nxansat, popullata edhe punëtortë. Ajo rezistenca e viteve ‘81-’82.

Anita Susuri: Qysh mundeni me na përshkru situatën që e keni pa? Qysh ka qenë krejt në qytet me dhunë prej policisë?

Skender Muçolli: Dhuna si gjithmonë, ni dhunë policore, ni dhunë prej policëve civil edhe të uniformum. Po gjithmonë me ni shpresë që në atë pjesë të policisë ka edhe shqiptarë të cilët nuk mendojnë sikurse ajo pjesa shtetnore. Ishte knaqësi që u shifte evoluimi edhe zhvillimi i rezistencës ditë për ditë ma shumë. Ditë për ditë ma fort. Kështu që edhe koha e boni ata të vetën që rezistenca zhvillohej dhe u forcu deri me shpërthimet e ma vona edhe me luftën direkte.

Anita Susuri: A ju kanë marrë gjatë kësaj kohe edhe në biseda informative si ish i burgosur politik?

Skender Muçolli: Po ka pasë edhe biseda të shkurta, përcjellje të vazhdueshme në vend të punës.

Anita Susuri: Qysh e keni vrejt për shembull që po ju përcjellin?

Skender Muçolli: E kam vrejt. Vishin hetuesit te drejtori, a e keni filanin këtu në punë? “Po”, “Çka punon? Çka bon? Çka kryen?” Kësi. Domethonë ishim në vëzhgim të përhershëm. Po mu m’ka ra me u marrë me inxhinieri kështu që inxhinieria nuk ka pasë kësi sene të theksune. Mu më dërgojshin nëpër punishte, ku kontraktoshin firmat e Serbisë, firmat e Maqedonisë, firmat e Kroacisë. Nuk kom punu me firma të shqiptarëve ku ishin udhëheqës shqiptarë. Po...

Anita Susuri: Ju kanë dërgu me qëllim?

Skender Muçolli: Me qëllim për shkaqe të sigurisë, shkaqe... unë kom pasë dobi tani në profesion prej atyne firmave të Kroacisë e të Serbisë. Sigurisht ishin ma të avancune ma të pregatitun, me mësu zanatin edhe e kom mësu zanatin e tyne. Qat’ dobi e kom pasë.

Anita Susuri: Mas vitit ‘81 ka ndryshu pak marrëdhanja ndër etnicitetet këtu në Kosovë. Po më intereson edhe n’punë te ju qysh ka ndryshu raporti? A keni pasë kolegë serbë ose...

Skender Muçolli: Po, po kuptohet shumë...

Anita Susuri: Si ka qenë raporti?

Skender Muçolli: Tash ajo, këto kanë qenë forma organizimi. Komiteti i ka bo ato sene, komiteti ka reprezentu pushtetin. Popullata... marrdhanje kolegjiale normale, në profesion kanë qenë normale ato. Në profesion kem pasë musliman, kem pasë malazez, kem pasë boshnjak, kem pasë serb. Kem pasë profesione, profesione. Kuptohet gjithmonë ata kanë qenë ma të pregatitun se ka pasë kush i udhëzon. Kanë pasë eksperiencë ma të madhe se ne shqiptartë. Ata duhet me pranë.

Po unë kom pasë fatin me ni musliman të Plavës dhe Gucisë. Ai prejardhje muslimane, prejardhje shqiptare, qisi gjuhën të përzine, halla, dajt a diçka te shqiptartë. Me to kom punu vazhdimisht deri në fund. U vrejke ni punësim, ni avansim i shqiptarëve. Jo në atë kuptimin e zhvillimit e të atyne po thjeshtë punësimi edhe rreth punësimit me kompetenca gjysmake kuptohet.

Se s'kanë mujtë ndërmarrjet e Kosovës me u plasu aq shumë se s'ka leju dikush me u zhvillu ashtu, me u avansu ashtu. Po gjithmonë me ni ritëm shumë ma të ulët sesa tjetër. Këto forma kanë shkaktu paknaqësinë e përgjithshme deri në shkatërrimi i asaj forme, arrin shkatërrimi i asaj forme. Ish Jugosllavia shkatërrohet vetvetiu nga mrena për shkaqe t'padrejtësie që dominimi, dikush mbi dikun që ka bo...

Anita Susuri: Po më intereson tash edhe për punën e juaj çka osht' ndërta ma shumë në Kosovë n'atë kohë?

Skender Muçolli: Po kur kom punu n'atë kohë ndërtimi i rrugëve, projektimi i rrugëve, ndërtimi i rrugëve. Dikund u ndërtojshin, kanë qenë të modernizune nga 1920 kilometra rrugë. Rrugët e para. Ndërtimi i rrugës për Pejë, ndërtimi i rrugës për Mitrovicë, Veternik, rruga e Shtimës, rruga për Shtime, për Prizren, për Brezovicë, për Han të Elezit, Kaçanik, për Podujevë...

Anita Susuri: Faktikisht krejt rrugët janë ndërta në qat' kohë...

Skender Muçolli: Po në qat' kohë pat' fillu. Qat' kohë ka fillu procesi i ndërtimit të rrugëve prej vitit '65. '65-ten rrugët e para, '62 ni pjesë e asfaltit u bo. Ni pjesë e asfaltit, dy kilometra, asfalt i ftohtë, asfalt i ftohtë prej Pozharanit për Klllokot. Atëherë u maru asllati. Para asaj kohe ndërimi modern ka qenë me kubza, '56-ten, Stanitërg-Mitrovicë, prej Mitrovicë për Leposaviç, me kubëza katror. Ka qenë prej Peje-Deçan, prej Prishtine-Fushë Kosovë.

Tani Veterniku ka qenë me kubëza, me gur katror, para asfaltit. E asfalti '62-ten, asfalti i nxehtë punohet Deçan-Gjakovë. Hala ka pjesë të shnoha të asaj kohe. Naj kilometër të shnoh e gjon, '62. Meniherë pason kah Liqeni i Badovcit ndërtimi i rrugës, prej Prishtine për Gjilan ni pjesë. E para vitet e '65-ta. Tani vjet për vjet ka pasë ndërtime.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Vitin '90-të a ju ka ra edhe juve me lanë punën?

Skender Muçolli: '90-ten po.

Anita Susuri: Qysh ka ndodhë?

Skender Muçolli: Ka ndodhë asisoji, Serbia e suprimoj autonominë '89-ten. Tani '90-ten, '91 deri në '92 ka zgjatë ajo procedurë. Format ishin asisoji që u dufke me pranue sindikatën, thjeshtë me pranue pushtetin e aplikum të Serbisë. Ne s'u largum se e konsideronim largimin vullnetar po pritëm ni largim me dhunë. Se e konsideronim se na jem në vend tonë, në shpi tonë edhe s'pranojmë kurfar' forme tjetër. Erdhën drejtorët e dhunshëm. Më kujtohet se kom punu me [Igballe Novosellën](#) kom punue në qat' resor, 14 herë kanë pasë ardhë policia me largu me dhunë Igballen, 18 here. Nashta ka tregue nëse e keni pasë në intervistë, për këtë detal a din, s'e di a ka tregu a jo.

Nuk e pralum atë formën, s'e pralum pushtetin edhe shkum në shpi. E lam ni djalë aty me i pranue ato masa me qëllim që t'kem qasje në dokumenta. Dokumenta të projektit t'rrugëve. Se rruga ish siguria shtetnore. E din projektin e rrugës, e din projektin, naj rast na vyn ato letra. Çka u vërtetu ma vonë që na vyjtën. Për m'u mbrojtë ti duhet me ditë kah e sjell armikun rruga, cilat janë ato koridore, cilat janë ato rrugët lokale si rrugë të regjionit edhe rrugët kryesore. Po kryesore qat' inxhinieri, qat' teknikë në kohë të luftës ajo teknikë ka qenë shumë e aplikueshme për mbrojtje edhe për veprimtari tjera. S'mujti ai ma tepër se ni vjet po ni vjet na ka pasë furnizu me pjesë të arkivit.

Anita Susuri: Ai ka pasë presion e ka lanë pastaj?

Skender Muçolli: Tani ka pasë presione të ndryshme edhe me miratimin tonë, "Nuk ka nevojë ma tepër, s'po munësh me nejt mos rri. Ke dhanë kontributin tonë". Ai djalë tash osht' dikun në perëndim ka shku, u punësu meniherë atje në perëndim edhe s'ka nejt në Kosovë se s'ka pasë gjendjen familjare, t'ligë [e ka pasur] atëherë.

Anita Susuri: Po si shumë n'atë kohë...

Skender Muçolli: Po. Ai e ka pasë të theksune, e ka pasë të theksune.

Anita Susuri: Ju ndërkohë keni kriju familjen sigurisht...

Skender Muçolli: Po.

Anita Susuri: Keni pasë fmi...

Skender Muçolli: Po.

Anita Susuri: Edhe keni pasë përgjegjësi me mbajtë familjen...

Skender Muçolli: Po.

Anita Susuri: Me çka jeni marrë n'atë kohë?

Skender Muçolli: Po jom marrë unë me bujqësi jom marrë e djemtë e axhës, t'mixhës në fshat edhe ata tetë vllazën edhe ata janë marrë me bujqësi tani edhe unë me ata bashkë. Kem bo do mjete bujqësore, traktora, kombaja qisi sene jemi marrë direkt. Familja gjatë dhjetë vjetshit deri në '99-ten të ardhurat i ka pasë prej bujqësisë. Hala i kom unë ato qashtu, ekzistojnë ato maqina. Po qaty kom mujtë me ekzistu me to.

Anita Susuri: Sa fmi i keni?

Skender Muçolli: Dy vajza edhe ni djalë.

Anita Susuri: Kanë qenë të rritun në atë kohë ma merr menja?

Skender Muçolli: Jo, jo, jo. T'ri në atë kohë. 30 vjeçar janë dikun ata.

Anita Susuri: E bashkëshortja a ka punu edhe ajo?

Skender Muçolli: Ajo ka punu në Televizion të Kosovës.

Anita Susuri: Edhe ajo ka mbetë pa punë.

Skender Muçolli: Edhe ajo kohën e fundit ka mbetë pa punë sikur tanë tjerët. Deri në momentin e mram e ka shfrytëzue, momentin e mram s'ki ku shkon.

Anita Susuri: Po. Po më intereson tash në kohën kur ka fillu me u kriju këto, domethonë, UÇK-ja me u kriju e grupet e para, a keni qenë në rrjedha të kësaj, a keni ditë që po krijohet diçka?

Skender Muçolli: Po të gjitha grupet politike në agjendën e vet i kanë pasë këto forma. Tash kush cilit grup i ka taku ajo ka qenë pak ma e theksune, ma shumë a ma pak.

Anita Susuri: Po.

Skender Muçolli: Në vitet '96-'97 aktiviteti ka qenë ma i intensifikum. '97-ten veç u paraqit nevoja e organizimit ushtarak. Unë personalisht jam sistemu në atë pjesën e logjistikës me anë të këshillit për emergjencë në nivel të Kosovës. Aty ishte Zaim Kurti prej partive politike se ka pasë edhe këshillin e partive politike prej partisë parlamentare. Unë e kam zëvendësu ndërkohë Zaimin për shkaqe shëndetësore ni kohë edhe direkt jam kyç edhe në operativën e kësaj veprimtarie të Këshillit të Emergjencës.

Ajo kupton format e ndihmës, pjesës ushtarake në zonë të Llapit, të Shalës, Drenicës. Ma vonë edhe Karadakut. Krejt koha na ka shkue nëpër qito zona, sidomos në zonën e Karadakut edhe të Llapit. Po edhe pjesa e Drenicës me Shalë të Bajgorës. Kem pasë depërtu deri te Gjakova me anë të ni motrës medicinale, Ajmana emrin, po më kujtohet edhe [Mevludë Saraçi](#) në Gjakovë ni aktiviste në atë kohë LDK më duket ka qenë në parti politike. Krejt koha na ka shku nëpër qito zona.

Kem qenë, kem pasë ekipin operativ me profesor nga Drenica, profesor në Fakultetin e Mjekësisë, se s'po më kujtohet ndërkohë. Mustaf Gara ka qenë në Medrese në Alaudin. Shaban Hoxha... e tjerë. Ka pasë plot tjerë që vazhdimisht kurrë s'janë nalë. Çdo ditë nëpër zona të luftës o' në Drenicë, o' në Shalë të Bajgorës në Llap. Qe profesori m'u kujtue, profesor i pandalshëm ka qenë Imer Halimi i Kozhicës të Skenderajit, tash në penzion është. Ai fakultetin e maqinerisë e ka pasë fillu, elektroteknikën, maqinerinë më doket në atë kohën e '68-ta. Ai e ka pasë këtë burimin nga '68-ta nga ana e teknikës, inxhinieria. Kontributi me këta persona. Diçka lloji tjetër...

Anita Susuri: Qysh ka qenë m'i vizitu qito vende në qat' kohë? Rrezikshmëria?

Skender Muçolli: Po ka pasë nevojë. Këshilli i Emergjencës si në të holla si në pjesë tjera... t'hollat kuptohet, ka pasë nevojë për t'holla janë dërgu të hollat, janë dërgu ushqimet, veshmbathja, janë dërgu shtofna të ndryshëm për uniforma. Janë dërgu uniforma, barna edhe armatimi kuptohet. Pjesëmarrja në armatim, dërgesa e armëve të caktune, pjesa financiare për blerjen e tyre, koordinimet me zona ose me komandant të zonave.

Komandant Remin po e zo personalisht për këtë qashtje osht' kontaktu edhe osht' vepru. Në zonë të Drenicës kta kolegët Imer Halimi me Sami Lushtakun në kontakt ka qenë. Shaban Hoxha me Sulejman Selimin. Mustaf Gara me Fatmir Limën. Isë Kastrati u pat' angazhu tani direkt në luftë me pjesën e Karadakut. Ahmet Isufi... edhe me neve kuptohet. Ai kur kaloj në uniformë krejt na lidhshim qytet edhe komanda. Të rrezikun kuptohet në çdo formë të rrezikun po ashtu po formojke njeri, ashtu s'po dishe çka osht'. Në qoftëse veç u rrezikojshë ashtu u dufshe me u sistemu në komandë ose pjesë të komandës ose brikadave.

Anita Susuri: Po m'intereson për metodat, për shembull, që keni përdorë për me qenë domethonë të kamuflun me thanë ose mos me u... organizmi me qenë sa ma diskret?

Skender Muçolli: Po këto pjesët, armatimi ka qenë të mshefta. Ato u dufke m'i mshefë. Kurse këtë pjesën tjetër u munojshim në ilegale. Po gjithmonë t'u u rujtë. Mos me hupë aty shansën palidhje po pak m'u rujtë e çka s'mun m'u rujtë shko edhe direkt. Me letra u plotësojshim. Mallin që e dërgojshim në filan firma, po e çon në magazinë ose dyqan, venin e caktun. Aty tani vishin ushtarët e ushtrisë çlirimtare e marrshin nëpër ato punkte ose naj përfaqësues i tyne në atë dyqan e dike kujt po i dërgohet.

Ose direkt shkojshim deri në vendin e caktun patëm depërtu me kamiona deri në komandën kryesore. U çuditshin thojshin, "Kah erdhët ju? Kah i gjetët rrugët?" Unë i disha ato koridoret prej punës. E disha ku ka rrugë e ku s'ka e cila rrugë është e cila s'osht', ku ka urë e ku s'ka urë. E qisi sene. Ka pasë me kamiona do vullnetar, ka pasë familja, familja e Mehmet Hërticës ka dhanë kontribut. Drejt ka pasë mundësi, kamiona... ka dhanë djem shumë. Kanë marrë pjesë shumë ata direkt po edhe këtë pjesën e furnizimit të ushtrisë për nevoja, kanë dhanë kontribut të madh.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë edhe për përvojën e luftës, domethonë, veç në mars kanë fillu bombardimet, ku keni qenë ju në atë moment?

Skender Muçolli: Bombardimet na kanë zanë n'shpi. Na kanë zanë n'shpi edhe e kom pasë dikun kah 40 që ju thojshim n'atë kohë refugjat n'shpinë teme...

Anita Susuri: Në Prishtinë a?

Skender Muçolli: Po. Ata u shpërngulën prej lagjeve periferike. Filloj dhuna, mas bombardimeve kjo, filloj dhuna t'u i kallë shpitë edhe t'u vra aty këtu, me qëllim frikësimi. Të nesrit në mëngjes ka qenë lagja e rrethune. Ish ni lagje gjysëm periferike i bijke n'atë far' kuptimi me qendër. Aty kanë ardhë policia edhe në mahallë e kanë vra ni person i cili shprehet thotë, "A muj me marrë traktorin?" A dinë, na me dalë po dalim po p'e marrë edhe traktorin. I thotë, "Merre". Si e kthen shpinën, e vret. Kështu që na qitën prej shpijave krejt.

Ni natë para, pat' ni organizim për rezistim të armatosun. Do armë te Medresja me rezistu, ni automatik po nuk u rezistu se rrethanat erdhën asisoji nuk u rezistu në atë formë, met' me aq. Kështu që na... na qitën prej shpijave edhe unë vazhdova te familja e Ibrahim Gashi. Po përmenda emrin këtu. Te ai aty nuk kish pasë naj asi dhune. Thotë Ibrahim thotë, "Vendosu te na qitu, çka të bohet me neve tanve, bohet edhe me juve", thom, "Ibrahim jo se po shkoj në Breg të Diellit. Qaty e kom ni banesë", edhe u përshëndetëm me Ibrahimin.

Më kujtohet Ibrahim, nata e bombardimeve e thrras në telefon. "Ibrahim, qysh osht' situata anej?" Thotë, "Kanë fillu bombardimet edhe", thotë, "kjo osht' shenjë që fitum". Qy tash Ibrahim Gashi thotë, "Shenjë fort e mirë", thotë, "fitum". M'kujtohet si detal. Shkova në Breg të Diellit bujta ni natë, të nesrit prapë lagja e rrethune. Lagja e rrethune prapë. Na qitën prej banesave. Vazhdum nja 200 metra, 300

metra ni banesë tjetër. U vendosëm në atë banesë. Tamon jena vendosë në banesë ia kanë qit' shiritin banesës. Sikur policia që i ka këto trakat, shirit.

“Hajde me dalë prej ktuhit”, edhe prej asaj baneses. Që m'u bonë mu tri vena, njo, dy, tre. I katërti, ku me shku të katërtin. Hajde tash me hyp në kerr. N'kerrin, kerrin e kom pasë lanë temin, n'oborr kerrin. S'provova me lyp kerrin sikur ai traktorin. Ik gjej zgjidhje vetit. Hypim n'atë kerr, nantë vet. Qyteti ish shkret. Do bllokada ishin, s'bon me kalu kah Veterniku, do kah qyteti me ardhë kah kisha sot ku osht' kah drejtimi i Fushë Kosovës. As drejtim të Fushë Kosovës jo, po dikun te [rruga] “Bill Clinton”, ni bllokadë anej, policia krejt po në koridor tjetër s'dishim kah po shkojmë.

Kur jom dalë kah Termokosi edhe kjo pjesa tjetër aty ish ni koridor tjetër kah rrethi ku osht' për Veternik. Jo rrethi prej Bregut të Diellit, edhe ai bllokadë ka pasë. Aty i kom pa unë kerret, traktorat e mlum me najllon, kolonë Veternikut përpjetë. Qaty policia, ushtria na kanë qit' na kanë lanë ni koridor m'u kapë për Veternik. Qaty kem shku t'u mos ditë ku po shkon as katuneve, as hiç. Deri te udhëkryqi i Fushës të Pajtimit ose si i thonë sot te Dardha. Në atë moment u blloku rruga për Han të Elezit, për Kaçanik dhe vetëm u la e Brezovicës.

Rrugës të Brezovicës kolona e gat' menojsim që dikund po na çojnë naj llogor koncentrim, dikun naj lug t'maleve qaty. Sikur lufta e Bosnjës, qasi far' formash i ka pa, ato llogoret e përqendrimit i ka pa bo Serbia. Aty kolona u ndërpre tri-katër herë. Na kishim frikën hajt tash qitu na sistemojnë, na ndajnë femrat knej, fmija knena, burrat knenaj. Po ato ndërprime ishin bo vetëvetiu për pushime, ni kerr u nalë tjetri s'ka guxu me vazhdu. A din, n'atë far' kuptimi se pse u nalë ky hajt po nalëm edhe na se s'po mujmë me tejkalu, e majmë ni disiplinë.

Qashtu deri katër kilometra pa mrri në kufi ka ana e Sharrit për Tetovë. Katër kilometra e gjatë edhe s'ka pasë kolonë, na po presim në kufi. Qaty na ka nxan nata. Qaty na ka nxan nata. Aty kom taku unë pjesë t'familjes, t'axhallarëve kom taku. Tani dikush ka pasë naj polic që ka pasë komunikim me to. Bile erdh forma kush don m'u kthy po kthehem se kaloj kjo. Kjo formë kaloj. A bon m'u kthy, s'bon m'u kthy. Vendosëm gjysa e familjes m'u kthy. Axhallarët, ni axhë e kom pasë aty me çika të veta. Na djemt ni vlla s'disha kah ka shku hiç tjetri s'ka qenë këtu hiç. Na e pritëm me dalë në Tetovë. Kjo pjesa tjetër u kthy.

U kthyn në pjesën e qytetit, pjesa në qendër ku nuk u largu popullata në atë formë të dhunshme. Aty kanë nejtë, e kanë pritë luftën, përfundimin e luftës e kanë pritë. Na e kem pritë në Tetovë e prej Tetove me 12-tin nëpër Sharr jena kthye në shpi. Aty tana e kem pritë edhe forcat e KFOR-it kur kanë hy, e qishtu.

Anita Susuri: A keni pasë ma problem kur jeni kthy?

Skender Muçolli: Jo, gjendje lufte, atmosferë lufte po po msojke njeri me atë far' forme, s'po dike çka osht' frika. E mbaj mend në oborr, kur jom kthy në oborr, qikaq {shpjegon me duar të lartë rreth një metër} e kom gjetë barin në beton. Që ka ujitë se kërkush u rrit bari, rrin n'guri.

Anita Susuri: Qysh ka fillu pastaj rimëkëmbja? Kthimi n'jetë? Keni vazhdu punën?

Skender Muçolli: Jo punën kena vazhdu meniherë me 17 kena vazhdu punën, me 17 mars. Jo mars po qershor. Katër-pesë ditë përmas. Jena shku në punë e kena gjetë ato zyre të mbyllta. Menojshim që ka aty naj minim, ka naj ekspoziv e kanë menu... ishte organizimi ushtarak, kishte edhe n'qytet. Ish bo komanda e policisë sot ku osht' aleanca aty. Aty tani i njifsha ata personat. Persona i njifsha. Kështu që i mora edhe dy ushtar me veti edhe i çelëm dyrtë. I çelëm dyrtë e hym n'punë.

Anita Susuri: Keni vazhdu pastaj punën?

Skender Muçolli: Po, kem vazhdu pastaj punën. Tani ndërkohë u organizu edhe pushteti i komunës komanda e zonës ishte në, në Kolovicë. Aty u formu grupi për me reprezentu pushtetin e ri. Në krye të grupit ishte Mexhid Syla, advokat sot osht'. Ishte Selatin Novosella, nënkryetar i qatij grupi. Unë e kisha resonin e organizimit në urbanizëm, e kisha shërbime publike, në inspeksion. Tri a katër drejtori i kom pasë qat' kohë.

Fehmi Avolli ka pasë kadastrin, gjeodezinë. Akif Sheholli koordinimin me drejtori... rahmetli Rexhep Luci e ka pasë zhvillimin urban me... Agim Baca ka pasë ekonominë. Arsimin e ka pasë Mustafë Sopi, ai është rahmetli Mustafë Sopi. Ni luftëtar i njësisit Bija. Edhe ai advokat Selman Bogiqi ka pasë shërbimin e administratës. Të Drenicës janë edhe Bogiqët. [Skender Boshnjaku](#) ka pasë mjekësinë, shëndetësinë. Kontaktet e para grupi i boni nja katër-pesë vet në fillim tani masanej janë kompletue struktura e udhëheqjes së komunës ma vonë.

Paralelisht me BritKforin kena hy n'komunë. BritKfori ka qenë njësi, njësi e NATO-s angleze. Gurkat e para në Prishtinë kanë ardhë. M'kujtohet ai anglezi, kolonel Millt, njësia speciale britaneze. Ai merrke pjesë. Na dha do kartela të identifikimit, hala e kom atë kartelë unë të identifikimit. Si ia kallxojsha... se u mbledhshim çdo ditë vishin punëtortë me hi n'punë me kqyrë çka po bohet. U bojke aty ni masë e njerëzve edhe tash ata në derë të komunës s'kishin ushatarkët... ky majori Millti me ekipën e vet armatimi deri në dhom kuptohet. Veç ia qitsha kartelën tani hishim aty mrena.

Majshim kontakte me ta komplet ekipi jonë. Tani u kompletu ekipi jonë tani na prun edhe serbët na prun. Ashtu ish politika. Tash edhe aty i gjetëm ata... osht' interesant çka kem gjetë na aty kur kem hy nëpër zyre. Krejt t'çelne zyret të pa prekne. Gotat me raki deri n'gjystë raki, shishe po, dollapa po. Armatim kem gjetë. Atë armatim, çdo zyre ka pasë armatim, kuptohet. Ato nuk ia kem tregu ktyne anglezëve po anglezët veç te dera rrishin na kishe nëpër zyre po i pastrojmë, po kqyrim çka ka, çka

s'ka. Po përgatitim për fillimin e punës normale në atë far' kuptimi. Ato i dërgojshim tjetër kah. Kah dritaret dytësore nëpër dritare poshtë kah pjesa përdhese...

Anita Susuri: E pse? Për m'i marrë...

Skender Muçolli: Kish aty sistemi ushtarak hala ishte prezente. U dufke m'i hjekë ato me ia dhanë personave, s'u dike çka po bohet. E kështu fillum, startum. E majshim parimin me përqindje të punësut, kush janë të punësut. 70 me 30, 70 shqiptarë, 30 serb kishe. Ia fillun ata, ni ditë erdhën, ni ditë me thanë erdhën. T'dytën ditë ni serb, ni prej drejtorave në tregun e identifikon dikush në treg e gjakosin. Pshton ai diqysh edhe drejt në komunë vjen. Aty i ka pasë ushtartë. Anglezët i jepin strehim atina. Thotë, "Unë jom punëtor i komunës", qishtu, qishtu bon vaki.

Fillon aty meniherë ni trishtim i serbëve që ishin, që kishin fillu me ardhë n'punë. Të nesrit asnjë s'i kena pa, s'kanë ardhë asnjë. Jom prezentu unë para stafit, ma shumë me shqiptarë u dike po me serb. Thashë, "Dje e keni pasë ni drejtor sot e keni njo tjetër. S'ka lidhje na punojmë normalisht". E kështu filloj jeta në Komunën e Prishtinës. Tani ia fillum aty s'kishim çka s'ka pasë zhvillim, s'ka pasë, veç identifikim të ndërtesave, të kallne. Bom aty nifar' organizimi m'i identifiku ato ndërtesa. Filloj tregtia, filloja kapak qisi senësh. Tregu pat' fillue, tregu.

Fillum edhe me mbledhë t'holla. Pjesën administrative e ka pasë ni amerikan si zëdhëndës. Ai na pat' propozu, "Qysh punoni ju? Çka punoni? Tregu po merr t'holla na duhet m'i marrë si komunë t'holla", "Qysh?" Tha, "Hajde p'e jepim", na dha shembullin, "unë i kom 150 hektar i kom në Teksas, 75 janë t'ni vllau 75 t'mijat. E 75", tha, "ia kom dhanë me qire", thashë, "Edhe te na jepim", "Ai e punon tokën, i pagun do pare qishtu", tha, "po ia bojmë na me tregun në Prishtinë".

Qaty janë konë startet e para, mbledhja e të ardhurave. E thojke, "Tregu fiton e tregu na jep pare edhe na e kena ni dollap qitu i shtijmë edhe çka t'na vijnë për komunë punojmë", ky amerikan. S'po më kujtohet emri. Ai ndërkohë kish qenë sekretar i katërt a i pestë a i dhetë i Ambasadës Amerikane në Beograd. Në kohë të luftës kish pasë ardhë me OSBE si civil për m'i pa, me pa pjesën e Kleçkës. Dy-tri herë na tregojke detale kur ka ardhë ai. Gjeneral amerikan. Ai ka pasë vazhdu deri nja ni vjet gati.

Tani ka pasë shku në Haiti, ai amerikan Haiti ka pasë shku tani erdh ni gjerman. Veç amerikan këtua ka përmbajtë, na ka ruajtë, na ka këshillu si osht' ma mirë. Gjermani ish konë i pjesës lindore. Ai pak ma ndryshe, jo si gjerman po ma tepër si pjesa komuniste e Gjermanisë lindore. Ai ndikimi rus, ndikimi... nuk, nuk ishte sikur ky amerikan. A n'krye e ka pasë meksikanin, po formalisht ai meksikani. Qatëherë fillun tani partitë politike. LDK-ja, Edita Tahiri, edhe ata me participu. Se thojshin nuk osht' sistemi i UÇK-së është ma tepër i jo partive politike.

Aty bohet nifar' informimi ka pasë ardhë Zijadin Gashi për arsim, ka pasë për arsim. Shefki Gashi ka pasë ardhë përfaqësojke ai LDK-në dikond aty. Tani partitë social-demokrate u bon si ni këshill i partive

politike me ekzekutimin ku e udhëheqke Mexhid Syla me neve bashkë. Qaty deri janë bo zgjedhjet e para. Zgjedhjet e para. Tani s'di valla kush ka pa ardhë, ka ardhë ni Gashi, ni profesor ka ardhë si kryetar komune. Tani janë vazhdu ato. Ismet Beqiri e tjerë, e tjerë me vite kështu. Qe n'pika t'shkurta sa m'kujtohet mu me vite pak. Tani unë u ktheva 2001-ten u ktheva në veprimtarinë e rrugëve.

Anita Susuri: Deri 2014-ten.

Skender Muçolli: Deri 2014-ten. Niherë si qajo formë tani morën kompetenca shkun në nivel ma të naltë. Deri në ministri shkum e qashtu veprum edhe sot vepron. Nuk e aplikun në drejtori të rrugëve po bon ni far' forme tjetër.

Anita Susuri: Mirë zotëri Skender, ju falënderoj shumë!

Skender Muçolli: Me nder kofshi!